

1 - ... para ...  
2010/03/12 ...  
refuzimi apo jo.  
B. J.

3724  
1203 10



259

Z. D. Decolli

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
AVOKATURA E SHTETIT  
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

*Colbajati*

Bulvardi "Zogu I", Ministria e Drejtësisë, Tiranë Tel. & fax: 04 253 600, email kabinet@avokaturashetit.gov.al

Nr. 654 Prot.

Tiranë, më 12 .03.2010

**KALLËZIM PENAL**

**KALLËZUES:** Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit Znj. Ledina Mandia, me adresë: Blv. Zogu I, Ministria e Drejtësisë, Tiranë.

**OBJEKTI:** Kallëzim kundër shtetasve Ana Mitro, Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani dhe Eleni Mima për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të përdorimit të dokumentave të falsifikuar.

**BAZA LIGJORE:** Neni 283 i K.Pr.Penale, neni 186, parag. i dytë i K.Penal.



PARA

**PROKURORISË PRANË  
GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR  
DURRËS**

I nderuar Z. Prokuror,

Ju parashtroj si vijon kallëzimin penal kundër shtetasve Ana Mitro, Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, Polikseni Mima, Marjeta Mima për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të përdorimit të dokumentave të falsifikuar, parashikuar nga neni 186, parag. i dytë i K. Penal.

*12/3*

Këta shtetas janë paditës në procesin gjyqësor civil (*aktualisht shpallur data për gjykim para Gjykatës së Apelit Durrës*) kundër Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me objekt kundërshtim e vendimeve nr. 379, datë 28.12.2007, nr. 380, datë 28.12.2007 dhe nr. 384, datë 04.01.2008 të ZRKKP Durrës. Ky institucion përfaqësohet nga Avokatura e Shtetit në këtë proces gjyqësor.

Veprën penale të mësipërme shtetasit në fjalë e kanë kryer drejtpërsëdrejti me dashje duke paraqitur dhe përdorur si provë shkresore në procesin gjyqësor të përmendur më sipër, vendimin e gjykatës nr. 52, datë 12.03.1946, i cili bazuar në rrethana objektive, na krijon bindjen së është i falsifikuar.

Vendimi në fjalë në gjendjen "*siç është*" të krijon përshtypjen se këta shtetas janë bashkëpronarë me Z. Nikolla Shallvari dhe Znj. Maria Lubica (e veja e Miltiadh Shallvarit), mbi një pronë të ndodhur në fshatrat Hamallaj dhe Rrushkull, Durrës. Më tej, shtojmë se me vendimin nr. 01, datë 03.01.1997, këta shtetas kanë bërë saktësim të sipërfaqes të pronës. Po ashtu sipërfaqja është përcaktuar edhe me akt-ekspertimi gjatë gjyqimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Më vonë, ata i janë drejtuar AKKP me kërkesë për njohje, kthim dhe kompensim të pronës së mësipërme. Kjo agjenci ua ka rrëzuar me vendim kërkesën për moslegjitimim aktiv, pasi nuk provojnë cilësinë e të qenit ish-(bashkë)pronarë. Këto vendime të AKKP-së (*të cilat i kemi cituar më sipër*), shtetasit në fjalë i kanë kundërshtuar gjyqësisht. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur në favor të këtyre shtetasve. Kjo gjykatë, duke u bazuar në vendimin e gjykatës nr. 52, datë 12.03.1946 (*të paraqitur për herë të parë në gjykatë si provë shkresore nga këta shtetas dhe sipas të cilit njihen bashkëpronarë me Znj. Maria Lubica mbi pronën e pretenduar*), ka arsyetuar se këta shtetas kanë legjitimim aktiv. Pasi u ka njohur legjitimitet aktiv, Gjykata ka shkuar më tej duke ndryshuar vendimet e sipërcituara të AKKP-së.

Më konkretisht: (i) gjykata ka ndryshuar vendimin nr. 384, datë 04.01.2008 të ZRKKP Durrës dhe ka njohur të drejtën e pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve mbi një sipërfaqe prej 1.575.900 m<sup>2</sup> (157,59 ha), nga e cila u ka kthyer 1.507.500 m<sup>2</sup> (150,75 ha) dhe u ka kompensuar 68.400 m<sup>2</sup> (6,84 ha), (ii) gjykata ka ndryshuar vendimin nr. 380, datë 28.12.2007 të ZRKKP Durrës dhe ka njohur të drejtën e pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve mbi një sipërfaqe prej 1.647.000 m<sup>2</sup> (164,7 ha), nga e cila u ka kthyer 1.505.400 m<sup>2</sup> (150,54 ha) dhe u ka kompensuar 144.200 m<sup>2</sup> (14,42 ha) dhe (iii) gjykata ka ndryshuar vendimin nr. 379, datë 28.12.2007 të ZRKKP Durrës dhe ka njohur të drejtën e pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve mbi një sipërfaqe prej 22.294.100 m<sup>2</sup> (2229,41 ha), nga e cila u ka kthyer 8.263.500 m<sup>2</sup> (826,35 ha) dhe u ka kompensuar 14.030.600 m<sup>2</sup> (140,306 ha). Gjithashtu

261 9

gjykata ka njohur të drejtën e parablerjes për godinat shtetërore (repart ushtarak dhe dy godina të tjera shtetërore) në rast privatizimi.

Vendimi nr. 52, datë 12.03.1946 është paraqitur prej këtyre shtetasve me qëllim që të provojnë legjitimitimin aktiv si subjekte ish-pronarë që duhet të përfitojnë nga ligji nr. 9235, datë 29.07.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar. Në këto kushte, është mëse e qartë se vendimi nr. 52, datë 12.03.1946 tek i cili mbështeten këta shtetas për të provuar cilësinë e tyre si bashkëpronarë me Znj. Maria Lubica, është prova themelore dhe e vetme për të mbështetur kërkesën për njohje, kthim dhe kompensim të pronës. Provimi i falsitetit të kësaj prove rrëzon legjitimitimin aktiv të paditësave për t'iu drejtuar AKKP-së me kërkesë për njohje, kthim dhe kompensim prone si dhe për t'u ankuar gjyqësisht siç edhe ka ndodhur.

Më poshtë, po ju parashtrojmë më hollësisht argumentet që na krijojnë bindje të arsyeshme për falsitetin e vendimit nr. 52, datë 12.03.1946 dhe për konsumimin nga shtetasit e sipërpërmendur të veprës penale të sipërcituar.

1. Nga ana formale:

Vendimi në fjalë (gjithsej tre faqe) në krye të faqes së fundit (*që përmban dispozitivin*) përmban shënimin "Faqe-3-" Ky shënim mungon në faqen e dytë megjithëse për koherencë duhej të ekzistonte edhe në faqen 2 edhe në atë të fundit, ose as në faqen 2, as në atë të fundit.

Duke e parë dokumentin me sy të lirë krijohet bindja e arsyeshme se shkrimi në dy faqet e para nuk është i njëjtë me atë në faqen e fundit. Kjo për arsye se gerrat e faqes së fundit duken më të mëdha nga ato të dy faqeve të para si dhe të një lloji tjetër. Gjithashtu, konturet e gërmave në faqen e fundit janë më të pastra se ato të dy faqeve të para, çka krijon përshtypjen se janë shtypur nga makina shkrimi të ndryshme.

2. Nga ana e përmbajtjes:

Objekti i padisë së vendimit nr. 52, datë 12.03.1946 konsiston në pjesëtim pasurie, ndërkohë që diapozitivi vendos për deklaram të paditësave bashkëpronarë sipas pjesëve përkatëve të përcaktuara në diapozitiv. Pra, përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit (*dy fletët e para*) nuk përputhet me përmbajtjen e diapozitivit (*fleta e fundit*).

Nga sa më sipër, krijohet bindja e arsyeshme se fleta e fundit e vendimit nuk ka lidhje në aspekt formal dhe në përmbajtje me dy fletët e para. Gjithashtu, krijohet bindja e arsyeshme se fleta e fundit i është bashkëngjitur dy fletëve të para të vendimit nr. 52, datë 12.03.1946 nga i cili është hequr fleta e tretë e vërtetë që i përkiste këtij vendimi.

262

10

Nga faktet e mësipërme krijohet bindja e arsyeshme se vendimi nr. 52, datë 12.03.1946 është i falsifikuar dhe se shtetasit Ana Mitro, Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, Polikseni Mima, Marjeta Mima kanë konsumuar në bashkëpunim veprën penale të përdorimit të dokumenteve të falsifikuar, parashikuar nga neni 186, parag. i dytë i Kodit Penal.

**KALLËZUES**

**AVOKATURA E SHETIT**

**përfaqësuar nga,**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHETIT**

**LEDINA MANDIA**



130